



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 674/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Adnan Konushevci dhe Rustem Thaqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Lista e Pavarur – Bekim Jashari, paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të keqpërdorimit të fletëvotimeve, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 20.10.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. PRANOHET** pjesërisht e bazuar ankesa Anr.674/2021 e datës 18.10.2021, e paraqitur nga Lista e Pavarur – Bekim Jashari, paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të keqpërdorimit në vendvotimin nr. 2126B/01D, ashtu që I NDALOHET Enkela Koci me numër personal 1230819315, Kryesuese e Vendvotimit QV2126B/01D, në Skenderaj, pjesëmarrja në zgjedhje, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor për periudhën kohore, në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, nga dita e marrjes së vendimit.

**II. REFUZOHET** e pabazuar, pjesa e ankesës me të cilën ka kërkuar që të përsëritet votimi, në Vendvotimin QV2126B/01D.

## A r s y e t i m

Me datë 18.10.2021, PZAP, ka pranuar ankesë nga Lista e Pavarur – Bekim Jashari, me të cilën pretendon se: në vendvotimin nr. 2126B/01D, gjatë numërimit të votave nga anëtarët e KVV-së, përmes vëzhguesi të tyre Gëzim Behrami është verifikuar që 1 fletëvotim ka qenë i pa vulosur në kutinë e votimit për Kryetar Komune, që lenë shumë dyshime për vjedhje të votave përmes “trenit bullgar”. Gjithashtu kërkon nga PZAP, që të përsëritet votimi në këtë vendvotim.

PZAP, më datë 19.10.2021 i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesë për përgjigje lidhur me ankesën Anr.674/2021 me të cilën ka kërkuar që t'i ofrojë PZAP-së Librin e Vërejtjeve për vendvotimin nr. 2126B/01D.

Duke vepruar sipas kërkesës së PZAP-së, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 19.10.2021 ka paraqitur pranë PZAP-së Librin e Votimit për Vendvotimin nr. 2126B/01D, në Skenderaj Formularin e Përputhjes së të dhënave dhe Rezultateve për Kryetar Komune, Formularin i Përputhjes së të dhënave dhe Rezultateve për Kuvend Komunal.

Në përgjigjen në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me të cilën ka theksuar se: është e pa mundur të ndodh “treni bullgar”, për shkak të identifikimit të fletëvotimit me vendvotim sepse fletëvotimet kanë numrin serik unik dhe numrin e vendvotimit të personalizuar dhe nga ana tjetër këshilli i vendvotimit është përbërë nga 5 anëtarë. Gjithashtu thekson se në lidhje me pretendimet e ankuesit, PDK ka pranuar një deklaratë të Ardian Behrami, i cili thekson se në qendrën përkatëse të votimit procesi i votimit ka shkuar jashtëzakonisht mirë, si dëshmi shtesë ka bashkangjitur edhe raportet nga ekipet monitoruese KKZ-së në Skenderaj ku shihet se nuk është regjistruar ndonjë parregullsi, gjithë ashtu ka bashkangjitur edhe deklaratat e menagjerit dhe kryesuesit të atij vendvotimit.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën, në kuptim të nenit 117.3 të LZP-së gjeti se:

#### **Ankesa është pjesërisht e bazuar**

PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe provave të bashkangjitura, konstatoi se ankesa është pjesërisht e bazuar në pjesën që ka të bëjë se në vendvotimin lëndor është një fletëvotim i pa vulosur në kutin e votimit, kjo është konstatuar nga shkresat e ofruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Po ashtu nga formularët e përputhjes së të dhënave për Kryetar Komune dhe për Kuvend Komunal vërehen mospërputhje të numrit të fletëvotimeve në kutitë përkatëse, ashtu që në kutinë e votimit për Kuvend Komunal janë 136 fletëvotime ndërsa në kutinë e votimit për Kryetar Komune janë 140 fletëvotime, andaj në raport me këto parregullsi paneli vendosi si në pikën -I-; të dispozitivit të këtij vendimi, bazuar në dispozitën ligjore të nenit 120 par.3, pika d), të LZP-së, në të cilin parashihet se: *“Në rast se ka ndodhur një shkelje e këtij ligji ose rregullave zgjedhore e cila e minon integritetin e zgjedhjeve PZAP-i mundet d) Ndalojë një individ të marr pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën*

*autoritetin e KQZ-së, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, për një periudhë kohore që nuk u kalon gjashtë (6) vite”. Lëshimet e pretenduara dhe te konstatuara nga paneli i atribuohen përgjegjësisë se kryesuesit te vendotimit sipas nenit 74.10, pasi integritetit i procesit mbetet përgjegjësi e kryesuesit. Me nenin 74.10 të LZP-së përcaktohet “ KVV-ja është përgjegjëse për sigurimin e integritetit, sigurisë dhe të qetësisë në procesin e votimit dhe numërimit në Vendvotim nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë nga KKZ-ja”.*

Në raport me pjesën refuzuese për urdhërimin e përsëritjes së votimit Paneli j vlerëson se mospërputhja e rezultatit konstatuar si më lart nuk është bazë e mjaftueshme dhe me peshë në rezultat për të urdhëruar përsëritjen e votimit në vendvotimin e pretenduar, bazuar në nenin 117 paragrafi 3 dhe nenin 118, të LZP-së, ngase nuk janë ofruar dëshmi të qarta dhe bindës se ka pas parregullsi të asaj natyre për te ndikuar në vendimmarrje ndryshe në këtë rast, siç është vendosur në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi.

Nga arsyet e lartcekura paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.674/2021 më datën 20.10.2021.



***Këshillë Juridike:*** *Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*